



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë: 17/05/2021

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

Për: Operatorin ekonomik: **Gentian Horjeti P.f** me NIPT **K31427013J**

Adresa: Rruga 5 Maji, ish-Ndërmarrja Kimike, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-67976-08-06-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë e hapur me objekt “**Blerje materiale bojaxhiu**”, kohëzgjatja e kontratës, marrëveshje kuadër me afat **deri 24 muaj** nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: **66 666 580** (*gjashtëdhjetë e gjashtë milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë*) **lekë pa tvsh.**

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21.09.2021, Ora: 09:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **VILA DEKOR** sh.p.k NIPT **L41329006M**, me ofertën ekonomike me vlere **48 024 560** (dyzet e tetë milion e njëzet e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH.**
2. Operatori ekonomik **GENTIAN HORIETI** p.f NIPT **K31427013J**, me ofertën ekonomike me vlere **58 757 696** (pesëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori ekonomik **DEUTHCOLOR** sh.a **NIPT L21326504J**, me ofertën ekonomike me vlere **53 619 180** (pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik **OL - VAHROM** sh.p.k **NIPT J93316628U**, me ofertën ekonomike me vlere **56 951 060** (pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik **I.D.K KONSTRUKSION** sh.p.k **NIPT K51408016J**, me ofertën ekonomike me vlere **42 993 560** (dyzet e dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH**.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **VILA DEKOR** sh.p.k **NIPT L41329006M**, me ofertën ekonomike me vlere **48 024 560** (dyzet e tetë milion e njëzet e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH, për arësyet e mëposhtme:**

1. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Boja për Fasadë (Akrilike)” [produkti nr.1 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “100% Akrilik”, me prodhues Vila Dekor shpk.

Raport testi në origjinal është paraqitur për produktin me emërtimin “100% Akrilik” të prodhuar nga Ol-Vahrom, ndërsa noterizimi i njehsimit me origjinalin dhe vërtetimi i përkthimit janë për raport test të paraqitur për produktin me emërtimin “100% Akrilik” të prodhuar nga Vila Dekor.

Vihet re që: Emri i produktit, nr. i partisë së prodhimit dhe datës së prodhimit janë njësoj në të dy raport testet (si të Ol-Vahrom dhe të Vila Dekor).

Pra ka mospërputhje në raport testin e paraqitur në origjinal dhe në raport testin e përkthyer dhe noterizuar, në lidhje me produktin e ofertuar. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

2. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Bojë Plastike” [produkti nr.4 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Plastiko”, me prodhues Vila Dekor shpk.

Raport testi origjinal në origjinal është paraqitur për produktin me emërtimin “Plastiko” të prodhuar nga Ol-Vahrom, ndërsa noterizimi i njehsimit me origjinalin dhe vërtetimi i përkthimit janë për raport test të paraqitur për produktin me emërtimin “Plastiko” të prodhuar nga Vila Dekor.

Vihet re që: Emri i produktit, nr. i partisë së prodhimit dhe datës së prodhimit janë njësoj në të dy raport testet (si të Ol-Vahrom dhe të Vila Dekor).

Pra ka mospërputhje në raport testin e paraqitur në origjinal dhe në raport testin e përkthyer dhe noterizuar, në lidhje me produktin e ofertuar. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

3. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Hidromat” [produkti nr.6 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Hydrochroma”, me prodhues Vila Dekor shpk.

Raport testi origjinal është paraqitur për produktin me emërtimin “Hydrochroma”, të prodhuar nga Ol-Vahrom, ndërsa noterizimi i njehsimit me origjinalin dhe vërtetimi i përkthimit janë për raport test të paraqitur për produktin me emërtimin “Hydrochroma” të prodhuar nga Vila Dekor.

Vihet re që: Emri i produkti, nr i partisë së prodhimit dhe datës së prodhimit janë njësoj në të dy raport testet (si të Ol-Vahrom dhe të Vila Dekor).

Pra ka mospërputhje në raport testin e paraqitur në origjinal dhe në raport testin e përkthyer dhe noterizuar, në lidhje me produktin e ofertuar. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

4. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Bojë Zmalto” [produkti nr.7 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Metal Care” me prodhues Er-Lac, ku në përshkrimin e tij në skedën teknike dhe në etiketën e mostrës së paraqitur cilësohet se ky produkt është i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe metalike kurse në DST është kërkuar bojë zmalto me përdorim të përgjithshëm në suva, dru, metal etj. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.7 në Shtojcën Nr.10.

5. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Llaç i Gatshëm” [produkti nr.16 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Premix” me prodhues Dekoll. Për këtë produkt është paraqitur në origjinal raport testi me nr. 1081100, datë 29.08.2017 dhe nr., aplikimi 2-0320 datë 18.07.2017 për metodën e testit EN 1015-11:2001+A1:2007.

Po ky dokument është paraqitur në origjinal, në dokumentin e njehsuar me origjinalin dhe vërtetimin e përkthimit, por përkthimi i testit të paraqitur është për raport testin me nr. 1081100, datë 26.09.2017 me nr. aplikimi 2-0320 të datës 18.07.2017 për EN 1015-12, EN 1015-18, EN 1015-19 dhe EN 1745:2015.

Pra bie në sy dukshëm mospërputhja e raport testit të paraqitur në origjinal me raport testin e përkthyer duke e bërë të pavlefshëm paraqitjen e këtij dokumenti pasi është përkthim i një dokumenti tjetër dhe jo atij të paraqitur nga ofertuesi. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.

6. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Kollë speciale kundër lagështirës (Hidroizolues)” [produkti nr.17 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Adesiflex” me prodhues Dekoll, konstatojmë se në skedën teknike të paraqitur për produktin cilësohet se fusha e aplikimit të tij është për ngjitje pllakash mermeri, guri dyshemeje, muresh etj. dhe nuk ka në përbërjen e tij asnjë efekt hidroizolues siç kërkohet në DST. Gjithashtu ky produkt në skedën teknike të publikuar nga prodhuesi në faqen e tij zyrtare rezulton si produkt më vete dhe jo si produkt me dy komponentë me efekt kundra lagështirës.

Për më tepër raport testi për produktin “Adesiflex” i paraqitur me nr. 1180347, i datës 13.06.2018, me nr.aplikimi 2-0445, datë 26.03.2018 provon përmbushjen e standarteve EN 1346:2008, EN 1348:2008, EN 1308:2009 dhe EN 12002:2009. Nga verifikimi i këtyre standarteve rezulton që këto standarte janë për produktin kollë të thjeshtë për ngjitjen e pllakave dhe jo për kollë speciale kundër lagështirës (hidroizolues), ku standarti që duhet të përmbushë ky i fundit i kërkuar dhe në DST është për EN 14891:2017, për produkte të papërshkueshëm nga uji. Asnjë nga standartet që përmbush produkti i ofruar nuk është ekuivalent me standartin e e kërkuar nga AK në DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.17 në Shtojcën Nr.10.

7. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Furçë për lyerje me gëlqere profesionale” [produkti nr.18 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Wall Brushes and White Wash Brushes”, me prodhues Token Tooling. Skeda e këtij nuk është paraqitur në origjinal për më tepër është fragment katalogu i marrë nga prodhuesi Tolsentools (prodhues i cili nuk ka asnjë lidhje me prodhuesin e produktit të ofruar Token Tooling) dhe mungon dhe njehsimi me origjinalin për dokumentin e paraqitur si përkthim. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.3 e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

8. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.2.4 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9, vlera e faturave të ngjashme të paraqitura nuk e plotëson shumën 40% të fondit limit. Fatura me nr.76075635 datë 14.05.2019 me vlerë 1 020 416 lekë pa tvsh dhe fatura me nr.820 datë 27.09.20183 me vlerë 818 333 lekë pa tvsh janë paraqitur nga dy herë secila dhe shuma totale e të gjitha faturave të paraqitura nuk e plotëson vlerën 40% të fondit limit (26 666 632 lekë pa tvsh) sipas kërkesave të DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.2.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

2. Operatori ekonomik **DEUTHCOLOR** sh.a NIPT L21326504J, me ofertën ekonomike me vlere **53 619 180** (pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë) **lekë pa TVSH**, për arësyet e mëposhtme;

1. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Bojë fasade (akrilike)” [produkti nr.1 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Alpen Classic QL11” me prodhues Deutchcolor. Nga shqyrtimi i mostrave të paraqitura rezulton që janë paraqitur në konfeksion 3 (tre) litra kurse referuar kërkesave të Specifikimeve Teknike në Shtojcën Nr.10 autoriteti kontraktor ka kërkuar që produkti të ofrohet në konfeksion 5-15litra. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.1 në Shtojcën Nr.10.

2. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Kollë speciale kundër lagështirës” [produkti nr.17 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Izoflex 2KF” me prodhues Dast. Nga shqyrtimi i mostrave të paraqitura rezulton që janë paraqitur paraqitur me konfeksion 13kg komponenti A dhe 4 kg komponenti B kurse në DST është kërkuar në konfeksion 20-30kg komponenti A dhe 5-10

kg komponenti B Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.1 në Shtojcën Nr.10.

3. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për plotësimin e pikës 2.3.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 ofertuesi ka paraqitur katalog të prodhuesit Cìret s.ro të Republikës Çeke. Nga shqyrtimi i katalogut konstatojmë që skedat teknike dhe fragmentet e katalogut të paraqitura për këto produkte nuk janë paraqitur të përkthyer dhe të noterizuara por në gjuhë të huaj. Konstatojmë që për produktet me nr. rendor, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 18, 21, 22 të Shtojcës Nr.10 nuk janë paraqitur të përkthyer apo noterizuara. Rrjedhimisht nuk plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.

3. Operatori ekonomik OL - VAHROM sh.p.k NIPT J93316628U, me ofertën ekonomike me vlere 56 951 060 (pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për arësyet e mëposhtme:

1. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Llaç i Gatshëm” [produkti nr.16 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Premix” me prodhues Dekoll. Për këtë produkt është paraqitur në origjinal raport testi me nr. 1081100, datë 29.08.2017 dhe nr.,aplikimi 2-0320 datë 18.07.2017 për metodën e testit EN 1015-11:2001+A1:2007.

Po ky dokument është paraqitur në origjinal, në dokumentin e njehsuar me origjinalin dhe vërtetimin e përkthimit, por përkthimi i testit të paraqitur është për raport testin me nr. 1081100, datë 26.09.2017 me nr. aplikimi 2-0320 të datës 18.07.2017 për EN 1015-12, EN 1015-18, EN 1015-19 dhe EN 1745:2015.

Pra bie në sy dukshëm mospërputhja e raport testit të paraqitur në origjinal me raport testin e përkthyer duke e bërë të pavlefshëm paraqitjen e këtij dokumenti pasi është përkthim i një dokumenti tjetër dhe jo atij të paraqitur nga ofertuesi. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.

2. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Kollë speciale kundër lagështirës (Hidroizolues)” [produkti nr.17 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Adesiflex” me prodhues Dekoll, konstatojmë se në skedën teknike të paraqitur për produktin cilësohet se fusha e aplikimit të tij është për ngjitje pllakash mermeri, guri dyshemeje, muresh etj. dhe nuk ka në përbërjen e tij asnjë efekt hidroizolues siç kërkohet në DST. Gjithashtu ky produkt në skedën teknike të publikuar nga prodhuesi në faqen e tij zyrtare rezulton si produkt më vete dhe jo si produkt me dy komponentë me efekt kundra lagështirës.

Për më tepër raport testi për produktin “Adesiflex” i paraqitur me nr. 1180347, i datës 13.06.2018, me nr.aplikimi 2-0445, datë 26.03.2018 provon përmbushjen e standarteve EN 1346:2008, EN 1348:2008, EN 1308:2009 dhe EN 12002:2009. Nga verifikimi i këtyre standarteve rezulton që këto standarte janë për produktin kollë të thjeshtë për ngjitjen e pllakave dhe jo për kollë speciale kundër lagështirës (hidroizolues), ku standarti që duhet të përmbushë ky i fundit i kërkuar dhe në DST është për EN14891:2017, për produkte të papërshkueshëm nga uji. Asnjë nga standartet që përmbush produkti i ofruar nuk është

ekuivalent me standartin e e kërkuar nga AK në DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.17 në Shtojcën Nr.10 dhe kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

3. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Bojë Zmalto” [produkti nr.7 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Metal Care” me prodhues Er-Lac, ku në përshkrimin e tij në skedën teknike dhe në etiketën e mostrës së paraqitur cilësohet se ky produkt është i përshtatshëm për përdorim në sipërfaqe metalike kurse në DST është kërkuar bojë zmalto me përdorim të përgjithshëm në suva, dru, metal etj. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.7 në Shtojcën Nr.10.

4. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 ofertuesi ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë në përdorim që ka operatori ekonomik në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tij në Gjirokastër. Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Thjeshtë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Operatori ekonomik Ol-Vahrom shpk me NIPT J93316628U, ushtron aktivitetin e tij edhe në tre vende të ndryshme sipas adresave të mëposhtme 1.Rruga e Durrësit, Pranë Doganës (Laprakë), Tiranë, 2.Rruga Selaudin Zorba, ish Serat, Tiranë, 3.Rruga e Dibrës, Nr.403, Tiranë, për të cilat ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për adresat e sipërcituara. Rrjedhimisht nuk provon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në lidhje me vendodhjet e ushtrimit të aktivitetit të tij cituar më sipër dhe përfundimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

5. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Furçë për lyerje me gëlqere profesionale” [produkti nr.18 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Wall Brushes and White Wash Brushes”, me prodhues Token Tooling. Skeda e këtij nuk është paraqitur në origjinal për më tepër është fragment katalogu i marrë nga prodhuesi Tolsentools (prodhues i cili nuk ka asnjë lidhje me prodhuesin e produktit të ofruar Token Tooling) dhe mungon dhe njehsimi me origjinalin për dokumentin e paraqitur si përkthim. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.3 e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

4. Operatori ekonomik **I.D.K KONSTRUKSION** sh.p.k NIPT K51408016J, me ofertën ekonomike me vlere **42 993 560** (dyzet e dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa TVSH**, për arësytet e mëposhtme;

1. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Stuko patinimi” [produkti nr.3 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Pintofinish” me prodhues Dekoll. Për këtë artikull është paraqitur në origjinal raport testi me nr.1081103, datë 29.08.2017, me nr. aplikimi 2-0320 / 18.07.2017 për metodën e testit EN 1015-112011 +A1 2017, në lidhje me rezistencën e përkuljes dhe shtypjes të stukos së ngurtësuar. Por mungon përkthimi dhe noterizimi i këtij raport testi. Rrjedhimisht nuk

plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.

2. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Llaç i Gatshëm” [produkti nr.16 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Premix” me prodhues Dekoll. Për këtë produkt është paraqitur në origjinal raport testi me nr. 1081100, datë 29.08.2017 dhe nr.,aplikimi 2-0320 datë 18.07.2017 për metodën e testit EN 1015-11:2001+A1:2007.

Po ky dokument është paraqitur në origjinal, në dokumentin e njehsuar me origjinalin dhe vërtetimin e përkthimit, por përkthimi i testit të paraqitur është për raport testin me nr. 1081100, datë 26.09.2017 me nr. aplikimi 2-0320 të datës 18.07.2017 për EN 1015-12, EN 1015-18, EN 1015-19 dhe EN 1745:2015.

Pra bie në sy dukshëm mospërputhja e raport testit të paraqitur në origjinal me raport testin e përkthyer duke e bërë të pavlefshëm paraqitjen e këtij dokumenti pasi është përkthim i një dokumenti tjetër dhe jo atij të paraqitur nga ofertuesi. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriereve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara të Shtojcës Nr.9 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranim/Kualifikimit.

3. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Kollë speciale kundër lagështirës (Hidroizolues)” [produkti nr.17 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Adesiflex” me prodhues Dekoll, konstatojmë se në skedën teknike të paraqitur për produktin cilësohet se fusha e aplikimit të tij është për ngjitje pllakash mermeri, guri dysHEMEJE, muresh etj. dhe nuk ka në përbërjen e tij asnjë efekt hidroizolues siç kërkohet në DST. Gjithashtu ky produkt në skedën teknike të publikuar nga prodhuesi në faqen e tij zyrtare rezulton si produkt më vete dhe jo si produkt me dy komponentë me efekt kundra lagështirës.

Për më tepër raport testi për produktin “Adesiflex” i paraqitur me nr. 1180347, i datës 13.06.2018, me nr.aplikimi 2-0445, datë 26.03.2018 provon përmbushjen e standarteve EN 1346:2008, EN 1348:2008, EN 1308:2009 dhe EN 12002:2009. Nga verifikimi i këtyre standarteve rezulton që këto standarte janë për produktin kollë të thjeshtë për ngjitjen e pllakave dhe jo për kollë speciale kundër lagështirës (hidroizolues), ku standarti që duhet të përmbushë ky i fundit i kërkuar dhe në DST është për EN14891:2017, për produkte të papërshkueshëm nga uji. Asnjë nga standartet që përmbush produkti i ofruar nuk është ekuivalent me standartin e kërkuar nga AK në DST. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.17 në Shtojcën Nr.10 dhe kërkesat e pikës 2.3 f) të Kapacitetit Teknik të Kriereve të Veçanta të Pranim/Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

4. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Llak për parket druri” [produkti nr.23 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Stone Lac” me prodhues Dekoll. Nga përshkrimi i produktit të ofruar në skedën teknike dhe në etiketën e mostrës së paraqitur konstatohet qartë që nuk është në përputhje me llojin e produktit të kërkuar në DST pasi cilësohet llak për përdorim në sipërfaqe guri, betoni etj. dhe jo në sipërfaqe druri duke e bërë të pavlefshëm këtë produkt për nevojat e AK. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.23 në Shtojcën Nr.10.

5. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Astar për parket druri” [produkti nr.24 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Wood decor” me prodhues Dekoll. Produkti i ofertuar nga OE si astar për parket druri nuk është në përputhje me specifikimet e kërkuar në DST, pra me përbërje polimeri poliuretani ose ekuivalent i tij, por është antimolë e cila ka një natyrë krejt të ndryshme përdorimi nga produkti i kërkuar duke e bërë të pavlefshëm këtë produkt për nevojat e AK. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktin me nr.24 në Shtojcën Nr.10.

6. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për “Furçë për lyerje me gëlqere profesionale” [produkti nr.18 në Shtojcën Nr.10], është paraqitur sipas ofertës teknike dhe mostrës produkti me emërtimin “Wall Brushes and White Wash Brushes”, me prodhues Token Tooling. Skeda e këtij nuk është paraqitur në origjinal për më tepër është fragment katalogu i marrë nga prodhuesi Tolsentools (prodhues i cili nuk ka asnjë lidhje me prodhuesin e produktit të ofruar Token Tooling) dhe mungon dhe njehsimi me origjinalin për dokumentin e paraqitur si përkthim. Rrjedhimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.3 e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

7. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.2.3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik/financiar në Shtojcën Nr.9 ofertuesi nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore nga të gjitha bashkitë në të cilat ai ushtron aktivitetin e tij ekonomik pasi nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve vendore për Vitin 2020 në Bashkinë Tiranë. Rrjedhimisht nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

8. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.2.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik/financiar në Shtojcën Nr.9 vlera e kontratave të ngjashme të paraqitura nuk e plotëson shumën 40% të fondit limit sipas kërkesave të DST. U konstatua që tre kontrata dhe faturat të paraqitura janë përtej afatit kohor të përcaktuar në DST dhe pesë kontrata dhe fatura të paraqitura nuk janë furnizime malli sipas objektit të prokurimit por janë kontrata për kryerjen e punëve publike.

Nuk klasifikohen kontrata të ngjashme pasi nuk janë furnizime mallrash sipas objektit të prokurimit kontratat si vijon: Fatura tatimore e datës 03.08.2019 me objekt “Lyerje në kabanon industrial”, kontrata e datës 26.08.2019 me objekt “Lyerje e objekteve ndërtimore”, kontrata e datës 09.02.2016 me objekt “Ndërtim objekt kabanoni parafabrikat”, kontrata e datës 27.10.2015 me objekt “Plotësimi rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”, kontrata e datës 20.05.2019 me objekt “Furnizim dhe vendosje snjalistike rrugore”, nuk klasifikohen kontrata të ngjashme pasi nuk janë furnizime mallrash sipas objektit të prokurimit.

Nuk klasifikohen kontrata të vlefshme për sa i përket afatit të kërkuar si vijon: Kontrata me datë 07.07.2017 me objekt “Blerje materiale sinjalistike rrugore”, kontrata datë 25.04.2017 me objekt “Blerje bojë sinjalistikë rrugore” dhe kontrata e datës 09.02.2016 me objekt “Ndërtim objekt kabanoni parafabrikat”. Rrjedhimisht nuk plotëson pikën 4 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

9. Për sa i përket dokumentacionit të paraqitur për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9 ofertuesi ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratën e energjisë në përdorim që ka operatori ekonomik në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tij në Vorë-Tiranë. Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Thjeshtë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezulton se Operatori ekonomik IDK-Konstruksion shpk me NIPT K51408016J, ushtron aktivitetin e tij dhe në dy vende të ndryshme sipas adresave të mëposhtme 1. Rruga Nacionale Korçë-Ersekë, km.8, krahu i djathtë, Korçë 2.Radesh, Nr.294/1, Çorovodë, Skrapar, për të cilat ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për adresat e sipërcituara. Rrjedhimisht nuk provon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në lidhje me vendodhjet e ushtrimit të aktivitetit të tij cituar më sipër dhe përfundimisht nuk plotëson kërkesat për pikën 2.e) të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në Shtojcën Nr.9.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **Gentian Horjeti P.f me NIPT K31427013J** me seli ne Adresë: Rruga 5 Maji, ish-Nderrmarrja Kimike, Tiranë, e paraqitur për tenderin me objekt **“Blerje materiale bojaxhiu”, REF-67976-08-06-2020**, me ofertë **58 757 696** (pesëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, me afat të lëvrimin marrëveshje kuadër deri 24 muaj nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe procedura e prokurimit do të anulohet sipas të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimet publike” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19/10/2020

Ankesa: Ka pasur.

Më datë 26.10.2020 Nr.3884 Prot. është paraqitur ankesë për vlerësimin nga operatori ekonomik Ol-Vahrom shpk. Autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje me shkresën Nr.3884/4 Prot. datë 02.11.2020, ku është vendosur mospranimi i ankesës. Operatori ekonomik Ol-Vahrom shpk nuk ka pranuar vendimin e Autoritetit Kontraktor dhe më datë 10.11.2020 ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr.202 datë 12.05.2021, administruar pranë institucionit tonë më datë 17.05.2021 me Nr.1665 Prot. ka vendosur të mos pranojë ankimin e operatorit ekonomik Ol-Vahrom shpk si të pabazuar në fakte dhe bazën ligjore në fuqi për prokurimin publik.

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erindi Bejko